



NJOFTIM PËR SHITJE PËRMES ANKANDIT TË PARË PUBLIK

Përmbaruesi Privat Rushit Hoxha në Prizren, me datë 24.11.2020 ka nxjerrë konkluzionin P.nr.164/20, mbi shitjen e parë publike të paluajtshmërisë së lënë hipotekë dhe atë:

Sipas fletës poseduese/ngastra kadastrale nr. **P-71510033-01015-24, P-71510067-01215-0, P-71510067-01216-0, P-71510067-01217-0** në sipërfaqe prej **1347, 2085, 2136, 4331 m2**, të cilat gjenden në Zonën Kadastrale **Xerxe, Radoste**, të evidentuara në emër të pronarit **Remzi Hoti**.

Paluajtshmëria është e vlerësuar në shumë prej **288,000.00 Euro**.

Paluajtshmëria e lartëcekur shitet me qëllim të realizimit–shlyerjes së obligimeve të debitorit **Lami Glass Ntp** përfaqësuar nga **Remzi Hoti**.

Në këtë seancë të ankandit të shitjes, paluajtshmëria nuk mund të shitet me çmimin që është më i ulët se **50%** e vlerës së përcaktuar me konkluzionin për shitjen, duke u bazuar në dispozitat e nenit 234 të Ligjit Për Procedurën Përmbarimore.

Data e ankandit - shitjes: **24.12.2020, në ora 10:00**

Vendi i ankandit - shitjes: **Zyra e Përmbaruesit Rushit Hoxha në Prizren,
Rr."Remzi Ademi" nr.94**

Të gjithë të interesuarit (ofertuesit) për blerjen e paluajtshmërisë duhet që më parë të deponojnë shumën e garancionit e cila duhet të jetë e barabartë me një të dhjetën e vlerës së përcaktuar të paluajtshmërisë, por nuk mund të jetë më e madhe se pesëmijë (5,000.00) Euro, me të drejtë të kthimit të kësaj shume ofertuesve, ofertat e të cilëve nuk janë pranuar.